



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



**INFORMATË RRETH AKTIVITETEVE TË KKSBB-SË PËR 6  
MUJORIN E PARË TË VITIT 2024**



**JANAR – QERSHOR, 2024**

## **HYRJE**

Të nderuar kuvendarë/e të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përgjatë periudhës janar- qershor 2024.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal, më datë 25.1.2022, ku anëtarët e këtij këshilli janë përzgjedhur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL, ku është bërë shpallje publike në të cilën janë përcaktuar kriteret të cilat duhet t'i plotësojë një kandidat për të qenë pjesë e këtij këshilli.

## **QËLLIMI I INFORMATËS**

Përmes kësaj informate, jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për kuvendarët/et dhe qytetarët, lidhur me aktivitetet dhe punët që janë kryer në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Kjo informatë ka për qëllim që ta rrisë transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

## **FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon në bazë të legjislacionit, i cili është në fuqi në Republikën e Kosovës, ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4, Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe vendimit të Kuvendit Komunal, më datë 25.1.2022.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi udhëhiqet nga Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi dhe Koordinatori i KKSB-së, z. Skender Hamza.

## **ANËTARËT E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANË:**

- 1.1. **Smajl Latifi** - Kryetari i Komunës, kryesues;
- 1.2. **Fazli Morina** - Komandanti i Stacionit të Policisë;
- 1.3. **Nysret Abazibra** - Bashkësia Islame – Rahovec;
- 1.4. **Ylvi Shehu** - Teqeja e Madhe “Shejh Sylejmani”;
- 1.5. **Sabahudin Durguti** - Teqeja e “Haxhi Shej Iliaz Shehut”;
- 1.6. **Milan Stanojevic** - Kisha ortodokse serbe;
- 1.7. **Biljana Nakalamic** – Komuniteti serb;
- 1.8. **Egzon Hamza** - Komuniteti egjiptian;
- 1.9. **Valon Berisha** - Komuniteti Rom;
- 1.10. **Bujar Morina** - Komuniteti ashkali;
- 1.11. **Bajram Morina**, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
- 1.12. **Abestrim Rexhepi** - përfaqësues i FSK-së;
- 1.13. **Alban Gashi** - Zyrtar për Barazi Gjinore;
- 1.14. **Avni Morina** - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
- 1.15. **Erseka Cana** - Kryetare e Këshillit të Prindërve;
- 1.16. **Enis Berisha** - KLSP;
- 1.17. **Beqir Hamza** - KEVSB;
- 1.18. **Shani Hoti** – Ratkoc, KLSP- Sektori C;
- 1.19. **Besmire Bytyqi** - Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.20. **Vjollca Gurguli** - SHL-Kosova;
- 1.21. **Lendrit Qelaj** - ZKKK;
- 1.22. **Shaip Shala** - Medie lokale;
- 1.23. **Mustaf Korenica** - Komuniteti i bizneseve;
- 1.24. **Lulzim Krasniqi**- Përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

#### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KKSBS-SË

Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi, identifikimi i dukurive negative, që mund të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit, bashkëpunojnë me policinë për parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi. Bashkëpunojnë me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt në bashkësi. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSBS-të, të komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre. Sigurimi i financimit të projekteve nga Kuvendi i Komunës që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi. Përmes Komunës, kërkon nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve që lidhen me sigurinë në bashkësi, fton në takimet e tyre përfaqësuesit nga MPB-ja dhe institucione të tjera gjegjëse, kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore. Mbajtja e takimeve të rregullta, bëhet sipas nenit 11, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL.

Kuvendi i Komunës, ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të këtij vendimi të anëtareve të KKSBS-së.

Anëtarët e KKSBS-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

#### AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2024

Në 6-mujorin e parë të vitit 2024, kryetari i Komunës i ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje urgjente të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku të gjitha këto mbledhje janë mbajtur sipas planit të aprovuar më 27.12.2023, pra janë respektuar të gjitha pikat e rendit të ditës së planit, gjithashtu ka pasur edhe pika shtesë, kjo është varur nga gjendja dhe situata e cila ka qenë në kohën kur është mbajtur takimi.

Përpos diskutimeve dhe debateve që janë bërë në këto takime, sa u përket pikave të rendit të ditës, gjithmonë në fund të takimeve janë marrë rekomandimet dhe konkluzat.

Më poshtë do t'ju paraqesim 5 takimet nga mbledhjet e Këshillit për Siguri në Bashkësi, si dhe pikat e rendit të ditës, po ashtu edhe konkluzat që kanë dalë nga këto takime.

Mbledhjet e mbajtura për vitin 2024 nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi janë:

### **Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKSB-së, e mbajtur më 31.1.2024**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2023;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
  - Siguria në trafik;
  - Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet;
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
4. Trajtimi i qenve endacakë;
5. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;
6. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
7. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;
8. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
9. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
10. Të ndryshme.

### **Konkluzion nga takimi i KKSB-së, i datës 31.01.2024**

**Konkluzionet, Kryetari - Rreth pikës së dytë:** Kontributi i komandantit të stacionit të policisë dhe i të gjithë anëtarëve është evident edhe gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, kemi ardhur në përfundim që gjendja e sigurisë në komunën tonë është stabile dhe pa cenime. Qytetarët e komunës sonë kanë një vetëdije të lartë, sepse kanë dëshmuar që interesi i përgjithshëm është me prioritet.

- **Konkluzion rreth pikës së tretë:** Kërkoj nga Inspektorati dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, të shenjohen parkingjet nëse nuk janë të shënuara.

- **Konkluzion rreth pikës së pestë:** Në gjysmën e parë të muajit shkurt, do të kujdesemi që ta organizojmë një takim me drejtore të shkollave, kryetarë të këshillave drejtues të shkollave dhe me koordinatorë të cilësisë, të pranishëm do të jenë edhe policia dhe psikologët.
- **Konkluzion rreth pikës së shtatë:** Do ta gjejmë formulën në bashkëpunim me ekspertët dhe me policinë dhe do ta organizojmë një trajnim për këtë çështje. Në fund, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata dhe me mirënjohje.



## **Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e urgjente e KKSB-së, e mbajtur më 28.2.2024**

1. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të sigurisë në Komunën e Rahovecit;
2. Të ndryshme.

### **Konkluzion nga takimi i KKSB-së i datës 16.03.2023**

**Konkluzioni rreth pikës së parë:** Ka ekzistuar një arsye themelore për ta thirrur këtë mbledhje urgjente!

Qëllimi i këtij takimi është që të konfirmoj rritjen e nivelit të gatishmërisë së organeve profesionale dhe kompetente, që i ka shteti ynë, në përputhje me kushtetutën dhe ligjet. Kjo mbledhje ka për qëllim rritjen e seriozitetit të të gjitha organeve komunale dhe të policisë, me qëllim që të krijojmë vazhdimisht klimë të qetësisë dhe të stabilitetit. Nga këtu konfirmoj bashkëpunimin më të mirë të mundshëm, me qëllim që të ballafaqohemi bashkërisht për kërcënimet e sigurisë që janë theksuar së fundi – plaçkitje, gjuajtje me armë, plagosje, rrahje dhe grabitje të armatosura.

### **Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 15.03.2024**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
  - Siguria në trafik;
  - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Rahovecit;
  - Vetëdijesimi i nxënëseve për rrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer nga lufta;
  - Trotuaret dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës;
  - Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike, konkretisht i trotuareve;
3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërftar;
5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të ndryshme.

### **Konkluzion nga takimi i KKSB-së, i datës 15.3.2024**

**Konkluzioni rreth pikës së dytë:** Dëshiroj ta theksoj faktin që ne kemi organe ligjore me detyra dhe përgjegjësi në fushëveprimtari të caktuara dhe të gjitha këto na japin të drejtën të themi që siguria në komunën tonë, pavarësisht veprimeve të dëmshme të keqbërësve, është e qetë dhe stabile.

- Kërkoj nga komandanti që policia të jetë më aktive në lirimin e hapësirave publike, sidomos të trotuareve. Po ashtu, ftoj edhe inspektoratin të tentojë ta zbusë gjendjen në të gjitha rrugët kryesore në qytet, sa u përket hapësirave publike, sepse kemi nevojë për veprime më efikase dhe jo vetëm.



#### **Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBS-së, e mbajtur më 14.5.2024**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,**
  - Siguria në trafik;
  - Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,
  - Prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm,
  - Vendosija dhe funksionalizimi i kamerave shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore;
- 3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- 4. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe i objekteve të vjetra, jo të sigurta;**
- 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**
- 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 7. Të ndryshme.**

#### **Konkluzion nga takimi i KKSBS-së, i datës 14.5.2024**

**Konkluzioni rreth pikës së dytë:** gjendja vazhdon të mbetet stabile, përkundër faktit që ka sfida, angazhime, përkushtime të secilit institucion, por edhe të komuniteteve, me qëllim që të ruhet edhe më tutje gjendja e sigurisë së përgjithshme. Pra, të ketë qëndrueshmëri dhe stabilitet, sepse për këto kemi nevojë më së shumti. Faleminderit komandant!

**Konkluzioni rreth pikës së tretë:** Besoj që fushata për edukimin, vetëdijesimin për rrezik nga zjarri dhe mbrojtja nga zjarri, do të vazhdojë dhe do të jenë temë aktuale, jo vetëm nga njësia e zjarrfikësve, po edhe nga të gjithë ne.

**Konkluzioni rreth pikës së katërt:** Të marrim hapa konkretë në këtë drejtim, kërkoj nga Gjeodezia, bashkë me Inspektoratin, Shërbimet Publike, së paku të tentojmë që pronat private të braktisura, që paraqesin rrezik të përgjithshëm për qytetarët, të mbrohet ose të rrënohet, sepse ato mund të shndërrohen edhe në vatrat ku kultivohen, ose ku shfaqen fenomene negative.







**Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSb-së, e mbajtur më 8.12.2023**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
  - Mirëmbajtja e rrugëve dhe e rrugicave gjatë stinës së dimrit;
  - Parkingjet në qytet gjatë stinës së dimrit;
  - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
  - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit.

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**



**Skender Hamza**

**Udhëheqës i Sektorit për Punë të Kuvendit**

